



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

KOMUNA E SUHAREKËS

DREJTORIA PËR EKONOMI, BUXHET DHE FINANCA

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE


2025–2027

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	faqe 3 - 5
II. Strategjia Zhvillimore Komunale – Deklarata e prioriteteve dhe Objektivat Aftatmesme Buxhetore ...	faqe 5- 9
III. Korniza fiskale 2025- dhe projksionet 2026-2027	faqe 10 - 20
A. Perspektiva e politikave fiskale	faqe 10
A.1. Korniza makroekonomike Komunale	aqe 10
A.2. Perspektiva e politikave fiskale	faqe 10 - 15
A.3. Të Hyrat Vetanake	faqe 16 - 21
IV B. Korniza Komunale e Shpenzimeve Buxhetore sipas programeve të njësive buxhetore	faqe 21- 46
V. Përformanca buxhetore komunale	faqe 47- 54
VI. Programi komunal i investimeve publike (PIP) 2025 dhe projeksionet 2026-2027	faqe 55 - 60

Hyrje

❖ Procesi Buxhetor fiskal 2025-2027



- Komuna jonë ka filluar ciklin buxhetor me shqyrtimin e prioriteteve nga viti paraprak, duke bërë një analizë të shpenzimeve dhe të hyrave të planifikuara dhe realizuara gjat vitit fiskal. Dokumenti është ndarë me të gjitha njësit buxhetore/drejtoritë/sectorët si kontribut për ciklin vijues buxhetor fiskal 2025-2027.
- Si fazë e dytë drejtoritë komunale janë mbledhur dhe kanë diskutuar Qarkoren e bënshme 2025/01 dhe agjenden e punës formularët e dërgur nga secili program buxhetor/drejtori/ në të cilat janë shpalosur kërkesat e tyre buxhetore si dhe të hyrat komunale për njësit buxhetore grumbulluese, për ato drejtori që realizojnë të hyra gjate vitit fikal 2025-2027 .
- Drejtoritë e komunës kanë filluar me plotësimin e këtyre formularëve (kërkesave) për shpenzime dhe të hyra për periudhën afatmesme buxhetore pasi kanë pranuar qarkoren e brendshme buxhetore me kufinj të buxhetor të përcaktuar dhe shpalosur në Qarkoren e parë Buxhetore 2025/01 që ka lëshuar Ministria e Financave Punës dhe Transfereve.
- Takime sqaruese dhe konsultuese janë zhvilluar me njësit buxhetore/drejtori/ të caktuara sipas kërkesave dhe nevojës deri në takimin e radhës për QB në vazhdim ku kërkesat buxhetore dhe të hyrat vetanake për periudhën afatëmesme buxhetore janë vendosur sipas kërkesave të njësive buxhetore .
- Drejtoria për Buxhet Ekonomi dhe Financa, përkatësisht Zyrtari Kryesor Financiar në bazë të kërkesave të pranura dhe shqyrtuara buxhetore si dhe planit për të hyrat ka përpiluar dokumentin në vijim, i cili do t'i dorëzohet Asamblesë Komunale për shqyrtim dhe aprovim si dhe së fundi Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës.

QËLLIMET
E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE PËR PRIUDHEN FISKALE
2025-2027

- Planifikimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027, mbrenda afatit ligjor të përacaktuar, do të bëhet në bashkëpunim me grupe të veçanta të interesit, si përmbledhje e projekteve të veçanta sektoriale dhe projekteve të tjera zhvillimore. KAB-i është punuar mbi bazat e praktikave të vendeve të zhvilluara të përshtatura me përvojën dhe praktikën lokale dhe të harmonizuara me nevojat, prioritetet dhe dokumentet strategjike të Komunës së Suharekës. Ky dokument në vete përmban veti zhvillimore në periudha afatshkurtëra, dhe afatëmesme.
- Suksesi i aplikimit dhe renditjes së këtyre segmenteve zhvillimore është qëllim i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 i cili në parim përmban qëllime dhe objektiva të cilat janë të realizueshme përmes projekteve të veçanta.
- Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB)-it Komunal të Suharekës është pergaditur si vazhdimsi e kornizave të viteve të mëparshme dhe është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të Republikës së Kosovës, e cila është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2025-2027 dhe agjendës me Qarkoren Buxhetore 2025/01 për Komuna e lëshur nga MFPT me 15.05/Maj/2024.
- Ajo përcakton analizat e mjedisit me qëllim të arritjes së objektivave strategjike të Komunës. Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale, paraqet një urë lidhëse në mes të procesit buxhetor e që njëherit bënë ndërlidhjen e resurseve e që në dispozicion me politikat, prioritetet dhe objektivat strategjike të përcaktuara të Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve buxhetore komunale gjatë periudhës së ardhshme trivjeçare.

- Me KAB-in Komunal do të paraqitën shpjegimet e politikave prioritetive të tanishme, objektivat afatmesme të Komunës së Suharekës si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën Buxheti i Komunës do të përmbushë objektivat e përcaktuara nga Qeveria Lokale për projektet me prioritet dhe me rëndësi të veçantë e që do të jenë drejtëpërdrejt në interesin e përgjithshëm të qytetarëve të cilat prioritetet do i përcaktojmë dhe përmbushim kërkesat të përcaktuara dhe të dizajnuara në Buxhetin për vitin fiskal kalendarik 2025-2027.

II. STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE – DEKLARATA E PRIORITETEVE DHE OBJEKTIVAT AFATMESME BUXHETORE

Baza për planifikim buxhetor dhe parimet

- Misioni i Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Suharekës mbështetet në objektivat strategjike të programit i cili program është bazë e strategjisë zhvillimore të Komunës dhe objektivat strategjike janë në pajtueshmëri dhe harmoni të plotë me të gjitha strategjitë dhe planet zhvillimore dhe urbane. Ky program është bazë për Planin e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës të Suharekës.
- **“Plani Zhvillimor Komunal(PZHK) 2018-2026”** që është bazë solide për zhvillim të planeve dhe strategjive afatmesme dhe afatëshkurtëra të Komunës së Suharekës. **Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027** është periudhë tri vjeqare për implementim të objektivave strategjike të të gjitha Planeve dhe Strategjive të miratuara të Komunës së Suharekës.

- Qëllimet e këtij dokumenti si dhe qëllimet e Kryetarit të Komunës të bazuara në dokumentet strategjike është që Buxheti i Komunës të ketë karakter të theksuar publik të shprehur jo vetëm në debate dhe dëgjime publike por të bazuar edhe në nevojat e theksuara nga qytetarët, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre.
- Me qëllim që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm, stabil dhe konform nevojave dhe prioriteteve të Komunës.Ne në zhvillim dhe hartim të këtij dokumenti kemi ndjekur praktikën e vendeve me ekonomi dhe demokraci të avancuar ku si synim është vendimmarrja, përgjegjësia dhe llogaridhënja qytetare dhe ajo komunale.
- Prioritetet e Qeverisë Komunale si shërbimet adekuate shëndetësore, qytet të pastër dhe siguri maksimale për qytetar, përmirësim të prekshëm të ambientit të biznesit, zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë dhe zhvillimit rural me të gjitha degët e saj, rritja e performancës në arsim për të gjitha nivelet, rritja e Buxhetit nga të Hyrat Vetanake Komunale, ambient komod për mërgatën, investimet me partneritet publiko-privat, thithja e fondeve të ndryshme, shërbime të shpejta për qytetarët, zhvillim të ekonomisë, turizmit etj janë të implikuara në investimet kapitale të këtij Buxheti afatëmesem.
- Ndarjet e Buxhetit sipas kategorive të shpenzimeve dhe fushave të ndryshme të jetës së qytetarit e bëjnë këtë **Buxhet investiv** pasi që **28.42% e këtij Buxheti shpenzohet ekskluzivisht në investime kapitale** dhe jo në shpenzime operative të administratës Komunale. Gjithashtu destinimi i këtyre investimeve bëhet jo vetëm në infrastrukturë publike por konsiderueshëm edhe në plane dhe programe zhvillimore si për ambient dhe klimë të shëndetshme të biznesit, bujqësi, blegtori etj, që dëmt se Buxheti ka karakter zhvillimor dhe investiv dhe jo vetëm shpenzues.

❖ VIZIONI

*Komuna e Suharekës është vend ku institucionet publike, private dhe qytetarët koordinojnë dhe bashkëpunojnë për të **maksimizuar mundësitë e zhvillimit ekonomik** që të krijohet një komunë dinamike dhe ka **destinacion tërheqës investues**, ku banorëte saj jetojnë, punojnë dhe mirren me biznes.*

*Është vend ku shtimi i **fuqisë punëtore të kualifikur dhe popullatës së re me arsimim të lartë** siguron mundësi sfiduese të punësimit në sektorin e biznesit dhe ku diversiteti i qytetarëve të saj është burim i përparësive. Suhareka është komunë ku **infrastruktura bashkohore**, dhe **ambienti i pastër dhe i shëndetshëm e që** janë bazë e fuqishme për objektivat e synuara. Është vend me **bujqësi moderne, me produkte të cilësisë së lartë dhe zhvillim të avansuar të blegtorisë.***

❖ MISIONI

Administratë Komunale në bashkëveprim me qytetarin për realizimin e objektivave strategjike për një administratë funksionale dhe sektoriale të Komunës së Suharekës.
Bashkëveprim produktiv sektorial për qështjet që prookupohet qytetari Yn gjatë marrjes së shërbimi në Administratën Komunale.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

- Objektivat strategjike të Komunës së Suharekës janë të fokusuar më tepër në qështje tematike të harmonizuara me qështje dhe mekanizmat sektorial të administratës Komunale, duke garantuar efikasitet dhe produktivitet të përbashkët të qështjeve të veqanta të sektorve të administratës Komunale.
- Bujqësi me produkte të cilësisë së lartë dhe blegtori e zhvilluar të cilat do të përkrahën dhe avancohen me instrumenta të prekshëm si subencionime të ndryshem për fermer aktiv dhe të sukseshëm në Komunë dhe më gjerë.
- Përmirësim i dukshëm i ambientit të biznesit, avancim të mëtutjeshëm të potencialit aktual të ndërmarrësisë dhe klimë për tërheqje të investimeve dhe donacioneve nga brenda dhe jashtë.
- Rritje e mjaftueshme e Buxhetit dhe investimeve të shoqëruara me ulje të taksave dhe Sherbimeve Administrative, zgjerim të bazës tatimore, krijim i burimeve të reja të të hyrave dhe vija buxhetore për thithje të granteve brenda dhe jashtë vendit.
- Arsimit të avancuar që i shërben fuqishëm diversitetit, përparësive dhe potencialeve të Komunës sonë.
- Shërbime shëndetësore të avancuara, implementim të projektiteve të ndryshme shendetësore si dhe funksionalizimi i QMF-ve në fshatra dhe ndërtimi i tjerave sipas nvojës së qytetarve.
- Urbanizim bashkëkohor, plane urbanistike në zona urbane dhe rurale të komunës.
- Turizëm me theks të veqant atë malor dhe ambient komod për mërgatën Kosovare.
- Ngritja e objekteve dhe poligoneve sportive për rini ,dhe sallave për edukatë si dhe ambiente tjera sportive e kulturore për të rinjët e komunës sonë.

**BURIMET E FINANCIMIT**

- Buxheti Komunal i përcaktuar dhe dizajnuar në KAB me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuar nga ana e Komunës përbehet nga granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit dhe granti specifik i shëndetsisë.
- Buxheti i ndarë është i përcaktuar nga Komisioni i Granteve i autorizuar nga MFPT-i e që ndarja e tyre bëhet në mbështetjeje te procedurave ligjore të aprovuara, nga donacionet e brendshme dhe të jashtme dhe nga të hyrat vetanake Komunale të përcaktuara sipas ligjit të financave të pushtetit lokal dhe projeksioneve të më hershme buxhetore për peiudhen buxhetore fiskale 2024-2026.
- ❖ **Granti i përgjithshëm.**-ndahet për komuna nga 10% i buxhetit total te Republikës së Kosovës. Granti i pergjithshëm ka dy komponente se pari çdo komunë përfiton **140.000,00 minus 1 € për qdo banorë të popullsisë** dhe komponenta tjeter sipas formules si në vijim.

❖ **1.1. Tabela e e Buxhetit sipas burimeve të financimit për vitet 2024-2027**

GRANTI I PËRGJITHSHËM			2024	2025	2026	2027	Pjesmarrja
Nr	Kriteri	Pjesmarrja në %					në % (2025)
1	Popullsia	89%	59,722				
2	Sipërfaqja	6%					
3	Komuniteti pakicë	3%					
4	Popullsia e komunave pakicë	2%					
Shuma e grantit të përgjithshëm			9,075,982.00	9,806,058.00	10,376,509.00	10,957,362.00	42.11%
GRANTI SPECIFIK I ARSIMIT							
Shuma e grantit specifik i Arsimit			8,245,932.00	8,596,834.00	8,854,739.00	9,120,381.00	36.92%
GRANTI SPECIFIK I SHËNDETSISË							
Shuma e Grantit specifik i Shëndetësisë			2,510,486.00	2,480,606.00	2,598,683.00	2,722,381.00	10.65%
TË HYRAT VETANAKE							
Shuma e të hyrave vetanake			9,075,982.00	2,401,424.00	2,595,608.00	2,793,123.00	10.32%
TOTAL BUXHETI KOMUNAL			22,084,869.00	23,284,922.00	24,425,539.00	25,593,247.00	100.00%



III. KORNIZA FISKALE 2025-2027

➤ A. PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE

A.1. Korniza makroekonomike Komunale

- Korniza Makroekonomike Komunale është në përputhje me Kornizën Makroekonomike 2025-2027 të Republikës së Kosovës dhe sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), si dhe Qarkoreve Buxhetore 2025/01. Korniza Makroekonomike është në harmoni me:
- Planin zhvillimor Komunal (PZHK) 2018-2026, dhe politikat strategjike komunale dhe në konsistencë **me Strategjin Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH) dhe Planin zhvillimor Komunal (PZHK) 2018-2026.**

• A.2. Perspektiva e politikave fiskale

- Politikat fiskale janë të orientuara që Buxheti Komunal të ketë një stabilitet dhe qëndrueshmëri të mjaftueshme që sigurohet nga burimet e të hyrat vetanake (politikës së të ardhurave, si nga Granti i Qeverisë, të hyrave vetanake komunale si dhe shpenzimeve).
- Për vitin fiskal 2025 parashifet një Buxhet **në rritje prej 5.43%** më shumë apo shprehur në vlerë prej **=1,200,053.00 € si mundësi për një zhvillim ekonomikë më stabil** e që është në harmoni me Qarkoren Buxhetore 2025/01.

- Kryesisht rritja e të **THV të planifikuara për vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak ka një rritje prej 6.61% e që THV të planifikuara për vitin aktual pritet të realizohen gjatë vitit fiskal 2024.**
- Pjesën më të madhë të hyrave vetanake e përbën tatimi në pronë , ku këtë vit ka një ngritje në faturim pasi që kufiri minimal i normës tatimore është ndryshuar me ligj nga 0.05% në 0.15%. Gjithashtu tatimi në pronë ka një ngritje të lehtë në arkëtim nga viti në vitë por që tatimi në tokë do të jetë sfidë në vete për tu inkasuar nga qytetaret.
 - Perspektiva e politikave fiskale është harmonizuar në objektivat strategjike si:
- Përmirsim i dukshëm i ambientit të të bërit biznes;
- Avancim të mëtutjeshëm të potencialit aktual të ndërmarrësisë ;
- Klimë për tërheqje të investitorve të brendshme dhe jashtëm si dhe
- Rritja e investimeve të shoqëruara me ulje të taksave dhe shërbimeve tjera Komunale, zgjerim të bazës tatimore, krijim i burimeve të reja të të hyrave dhe vija buxhetore-me bashkëfinacim për thithje të granteve si nga vendi ashtu edhe jashtë tij.

KOMUNA E SUHAREKËS

➤ Tabela 1.2. Paraqitja tabelare e Buxhetit sipas programeve (2024-2027)


Programe të buxhetore	Shpenzimet e Aktuale	Shpenzimet e Planifikuara	Projeksionet preliminare 2026-2027	
	2024	2025	2026	2027
1	2	3	4	5
Administrata Komunale	9,018,858.00	9,578,483.00	10,226,117.00	11,134,905.00
Administrata e arsimit	1,225,000.00	1,554,000.00	1,000,000.00	788,000.00
Arsimi & shkenca	8,741,525.00	9,027,833.00	9,962,739.00	10,258,381.00
Administrata e shëndetësisë	173,000.00	296,000.00	259,000.00	274,000.00
Shëndetësia primare -QKMF.	2,805,486.00	2,700,606.00	2,839,683.00	2,996,461.00
Qendra për punë sociale	121,000.00	128,000.00	138,000.00	141,500.00
Total:	22,084,869.00	23,284,922.00	24,425,539.00	25,593,247.00

1.3. Tabela buxhetore sipas kategorive ekonomike të shpenzimev 2024-2027


	Kategoria e shpenzimeve	Buxheti 2024 AKTUAL	Buxheti 2025	Buxheti 2026	Buxheti 2027	%	%	%
1	2	3	4	5	6	7=4/3	8=5/3	9=6/3
1	Pagat dhe medijtjet	11,392,153.00	11,650,345.00	11,909,419.00	12,195,381.00	102.27%	104.54%	107.05%
2	Mallrat dhe shërbimet	2,522,428.00	2,691,446.00	2,892,503.00	2,928,881.00	106.70%	114.67%	116.11%
3	Shpenzimet komunale	448,630.00	411,600.00	449,000.00	491,500.00	91.75%	100.08%	109.56%
4	Subvencionet transferet	500,000.00	620,000.00	605,000.00	660,000.00	124.00%	121.00%	132.00%
5	Shpenzimet kapitale	4,969,189.00	5,510,107.00	5,974,009.00	6,524,362.00	110.89%	120.22%	131.30%
	TOTAL: B.R.Kosovës	19,832,400.00	20,883,498.00	21,829,931.00	22,800,124.00	105.30%	110.07%	114.96%
1	Pagat dhe medijtjet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
2	Mallrat dhe shërbimet	626,000.00	647,000.00	706,000.00	724,000.00	103.35%	112.78%	115.65%
3	Shpenzimet komunale	138,000.00	146,000.00	159,000.00	166,000.00	105.80%	115.22%	120.29%
4	Subvencionet transferet	455,000.00	500,000.00	530,000.00	558,000.00	109.89%	116.48%	122.64%
	Shpenzimet kapitale	1,033,469.00	1,108,424.00	1,200,608.00	1,345,123.00	107.25%	116.17%	130.16%
	TOTAL: TH.Vetanake	2,252,469.00	2,401,424.00	2,595,608.00	2,793,123.00	106.61%	115.23%	124.00%
	TOTAL : Komunal	22,084,869.00	23,284,922.00	24,425,539.00	25,593,247.00	105.43%	110.60%	115.89%

- Nga tabela e lartëshenuar shifet se buxheti i vitit 2024 ka rritje prej 11.49% kurse viti 2024 ka rritje prej 17.24% përkatësisht 24.85% krahasuar me vitin fiskal aktual 2023 .


Grafiku i parqitjes së Buxhetit për vitin aktual 2024,planifikimi për vitin 2025 si dhe projeksionet për 2026-2027



Pjesëmarrja e të Hyrave Buxhetore në vitin 2025



Shpenzimet dhe pjesmarrja e tyre në Buxhetin për vitin 2025



- Nga Buxheti total i Komunës për vitin 2025, shifet **se pagat dhe Shtesat marrin pjesë me 50.03%**, Mallrat shërbimet me **14.34%**, Shërbimet komunale me **2.40%**, Subvencionet dhe transferet me **4.81%**, kurse **investimet kapitale janë planifikuar të marrin pjesë në këtë buxhet me 28.42%**.


• **A.3. TË HYRAT VETANAKE**

- Të hyrat Komunale Vetanake të Komunës realizohen në bazë të Ligjit për financat të pushtetit lokal, Rregullores mbi tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet Komunale.
- Rregullorës mbi tatimin në pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat Komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyrat tjera vetanake Komunale.
- Bazën e të hyrave Komunale e përbëjnë **Tatimi në Pronë dhe Tatimi në Tokë të cilet marrin pjesë me 50.32% në tatalin e të Hyrave Vetanake Komunale.** Për rëndesin e kalkulimit të përcaktimit të detyrimeve dhe grumbullimin e të hyrave nga kjo fushë, Komuna ka treguar një progres të shtuar në rend të parë në sensibilizimin dhe ngritjen e vetëdisimit të qytetarve për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe tatimit në tokë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale, si në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe projekte tjera zhvillimore Komunale.
- Që të hyrat- tatimet dhe taksat e grumbualluara nga qytetaret t'u kthehen të matrealizuara në të miren e tyre si dhe në shërbim të qytetarve.
- Të hyrave Komunale Vetanake të Komunës (THV) i kushtohet një rëndësi e veçantë rreth planifikimit sipas njësive buxhetore ku ato planifikohen si dhe me përkushtim të veçantë realizimit të tyre gjat tërë vitit fiskal.

➤ Tabela 1.4 Parashikimi i të hyrave vetanake 2025-2027, sipas Qarkores Buxhetore 2025/01

	Nr	Burimet e të hyrave vetanake	2024	2025	2026	2027
	Re		Të hyrave aktuale	Planifikim i të hyrave	Vlerësim i hershëm	Vlerësim i hershëm
Pjesa I	1	Tatimi në pronë	1,089,403.00	975,050.00	1,070,014.00	1,147,590.00
	2	Tatimi në tokë	233,993.00	233,306.00	272,872.00	330,176.00
	3	Taksat administrative-aktivitet	170,000.00	175,000.00	195,000.00	210,000.00
	4	Lejet ndërtimore	160,000.00	225,000.00	230,000.00	198,000.00
	5	Te hyrat nga shërbimet kadastrale	45,000.00	145,000.00	147,000.00	165,000.00
	6	Pëlqimet sanitare	15,000.00	20,000.00	23,000.00	30,000.00
	7	Qeraja e objekteve komunale	145,000.00	150,000.00	153,000.00	175,000.00
	8	Regjistrimi i pronës dhe transferet	15,000.00	15,000.00	16,000.00	20,000.00
	9	Dok.lindjes, vdekjes,martes,shkurorz	129,073.00	185,068.00	200,722.00	215,000.00
	10	Pagesat tjera	15,000.00	15,000.00	16,000.00	19,000.00
	11	Taksë nga regjistrimi i automjeteve	145,000.00	148,000.00	150,000.00	154,357.00
	12	Të hyrat nga arsimi parashkollor	15,000.00	38,000.00	40,000.00	42,000.00
	13	Të hyrat na arsimi - arsimi formal	15,000.00	12,000.00	12,000.00	12,000.00
	14	Të hyrat nga shëndetësia	60,000.00	65,000.00	70,000.00	75,000.00
Vitet Fiskale			2024	2025	2026	2027
Total : Të Hyrat Vetanake Komunale			2,252,469.00	2,401,424.00	2,595,608.00	2,793,123.00

- **Grafiku i planifikimit të T'hyrave Vetanake për vitin 2025,projeksionet për vitin 2026 -2027 si dhe viti aktual 2024**



- Nga grafiku i paraqitur shifet se T'hyrat Vetanake(THV) të planifikuara për vitet 2025 krahasuar me vitin aktual 2024 është planifikuar rritje, prej **6.61%** më shumë e që është një rritje reale e të hyrave vetanake .
- THV për vitet 2026 dhe 2027 kanë një rritje prej **15.23%** përkatësisht **24.00%** më shumë se viti aktual 2024.



A.4. Politikat e reja

- Në aspektin e të hyrave Komunale në periudhën afatmesme Komuna në bazë të zhvillimeve të inicuar nga niveli qendror në vitin fiskal 2019 ka shtuar një burim të ri të hyrash komunale – tatimi në tokë, ku në vitin e parë 2025 është faturuar rreth 95% e vlerës të të gjitha tokave në Komunën e Suharekës, ndërsa në vitet pasuese mbetet që çdo vit të rritet deri në tatimimin e plotë dhe në krijimin e një të hyre të qëndrueshme për Komunën tonë.
- Për vitin 2025 respektivisht për periudhën afatmesme në vijim të hyrat nga gjobat në trafik dhe gjobat nga gjykatat sipas udhëzimeve nga niveli qendror, planifikimin e tyre vazhdojnë ta bëjnë institucionet respektive nga ministrit e linjës që i grumbullojnë ato të hyra e të cilat do barten si të hyra të njëhershme në çdo tremujor në dobi të Komunës e që mjetet e grumbulluara do të investohen ekskluzivisht në projekte kapitale për mirëqenjen e qytetarve .



Huamarrja si burim i të hyrave vetanake

- Bazuar në performancën e arkëtimit të të hyrave vetanake Komuna me qëllim të rritjes së investimeve kapitale Komunës i mundësohet edhe marrje e huasë nga çdo institucion të Kosovës që jepë borgjë. Baze e mirë për hyrje në borgjë është qëndrueshmëria dhe rritja në vlerë e të hyrave vetanake komunale dhe opinioni i auditorit të përgjithshëm për Pasqyrat Financiare të Komunës. Të hyrat vetanake kanë performancë të lartë nga viti në vit ndërsa opinioni i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) në vitin 2020 ka marrë **opinion të Pamodifikuar** i cili llogaritet si raport shumë pozitiv kurse në vitin 2021 kemi **opinionin të modifikuar për PVF, por që për vitin 2022 sipas ZKA-së kemi Opinion të Pamodifikure kurse për vitin fiskal 2023 presim që ZKA-ja t'na jep vlerësimin si Opinoin i Pamodifikuar për PVF e që do jetë bazë e mirë për huamarrje dhe grante të ndryshme nga donatorët e brendshëm dhe të jashtëm** .
- Fokusimi i aktiviteteve në sigurimin e të hyrave nga donatorët e jashtëm dhe brendshëm. Objektivi parësor i Komunës është intensifikimi i aktiviteteve në sigurimin e donatoreve tjerë që kishin me kriju një bazë për një zhvillim dhe rritje të qëndrueshme të investimeve kapitale e cili për Komunën tonë është një faktor mjaft i rëndësishëm.

Pjesmarrja e qytetareve në buxhetimin lokal

- Komuna prioritetet i përcakton dhe i dizajnon në bashkëpunim me Buxhetimin e qytetareve të cilët buxhetojnë në përcaktimin e prioriteteve që kanë me rëndësi për përmbushjen e objektivave dhe nevojave të qytetareve. Përcaktimi përmes buxhetimit të qytetareve është i dizajnuar në propozimin e projekteve të cilat kanë nevojë më së shumti dhe janë prioritetet kryesore të tyre.
- Komuna pas propozimit të projekteve nga ana e vetë qytetareve ato i dizajnon dhe i përcakton objektivat kryesore të cilat mundë të i përmbush në bazë të burimeve të përcaktuara në buxhetin e Komunës dhe në KAB .
- Transparenca e Buxhetit Komunal është shumë e rëndësishme për Komunen dhe qytetaret e saj.
- Për Komunen është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e qytetareve në debate publike e cila e nderton besimin ndërmjet qytetareve dhe Komunës dhe në një mënyrë i jep legjitimitet vendimeve Komunale. Ky proces u mundëson qytetareve të kenë pronësi në buxhet dhe ndihmon në mbështetjen e tij që Komuna të menaxhoj buxhetin në mënyrë sa më efektive dhe transparente të dizajnuara në përcaktimin dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në bashkëpunim me aktivitetet lidhur me Buxhetimin e qytetareve të saj për tri vitet e ardhëshme fiskale.

❖ Llogaridhënja dhe menaxhimi i mirë i paras publike

- Objektivi strategjik i Komunës është krijimi i një administrate më efektive profesionale, transparente dhe në pajtim me parimet dhe standardet më të mira të mundshme demokratike të dizajnuar drejtë ofrimit të shërbimeve sa më cilësore si dhe në ecje me kohën për qytetaret e Komunës.
- Po ashtu me rëndësi të veçantë është orientimi i funksionimit të kontrollit në menaxhimin financiar sa më efikas të rreziqeve eventuale si parakusht për një menaxhim sa më efikas dhe ekonomik të parasë publike.

- Komuna do të përkushtohet për një menaxhim më efikas në identifikimin e të metave dhe mangësive, vlerësimin, dhe dizajnimin e kontrollit të brendshëm për përmisime si sfida më të rëndësishme të veçantë në arritjen e objektivave të përcaktuara për një menaxhim sa më efikas transparent të buxhetit të Komunës.
- Viti 2023 dhe viti 2024 është shquar për llogaridhënje të Kryetarit të Komunës rreth planifikimit të buxhetit pasi që Kryetari me stafin menaxhues ka mbajtur takime publike qoftë të karakterit “dëgjim publik”, debat publik apo takime konsultative në të gjitha fshatërat e Komunës dhe grupe të interesit dhe fokus grupe të qytetarve **për KAB-in 2025-2027.**

➤ IV. **B.KORNIZA KOMUNALE E SHPENZIMEVE BUXHETORE SIPAS PROGRAMEVE TË NJËSIVE BUXHETORE-**

DREJTORIVE

• B.1.Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

- Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen korniza e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pasqyruar bazën buxhetin e aprovuar për vitin 2024.
- Kjo kornizë paraqet parashikimin e përmbushjes së objektivave të përcaktuara strategjike tri vjeqare të shpenzimeve të përgjithshme Komunale. Të hyrat Vetanake Komunale janë përcaktuar, planifikuar si të inkurajuara me një tendencë për një trend optimist të rritjes për çdo vit fiskal.
- Grantet Qeveritare, të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të Buxhetit të cilat në vijim do të përcaktohen dhe lejohen nga komisioni i Granteve që vepron në kuadër të M.F.P.T-ës, të cilat Grante janë specifike për Arsim dhe Shëndetësi, e të cilat inkorporohen në Grantin e përgjithshëm të Komunës, si Buxhet total Komunal për periudhën tri vjeqare 2025-2027.

KOMUNA E SUHAREKËS

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-viti aktual,planifikimi për vitin 2025 dhe projeksionet për vitet 2026 -2027

📊 Tabela e shpenzimeve buxhetore 2025-2027 dhe vitit aktual 2024 sipas drejtorive, programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike

Drejtoria / Programi / Kaegoria Ekonomike	Viti 2024 Aktual	Palanifikimi 2025	Vlerësim i Hershëm 2026	Vlerësim i Hershëm 2027
Zyra e Kryetarit	299,000.00	307,000.00	313,000.00	322,000.00
Nr. i punëtorëve	18	17	17	17
Paga dhe shtesa	184,000.00	177,000.00	180,000.00	185,000.00
Mallra dhe shërbime	35,000.00	40,000.00	42,000.00	42,000.00
Mallra dhe shërbime THV	5,000.00	10,000.00	11,000.00	12,000.00
Subvencione dhe transfere THV	75,000.00	80,000.00	80,000.00	83,000.00
Administrata dhe Personeli	540,000.00	603,000.00	632,000.00	645,000.00
Nr. i punëtorëve	37	38	38	38
Paga dhe shtesa	255,000.00	283,000.00	290,000.00	295,000.00
Mallra dhe shërbime	190,000.00	210,000.0	225,000.00	225,000.00
Shpenzime Kapitale				
Mallra dhe shërbime THV	85,000.00	90,000.00	92,000.00	95,000.00
Shpenzime Kapitale THV	10,000.00	20,000.00	25,000.00	30,000.0
Inspekcioni	121,000.00	132,000.00	143,000.00	144,000.00
Nr. i punëtorëve	9	9	9	9
Paga dhe Shtesa	94,000.00	102,000.00	104,000.00	105,000.00
Mallra dhe shërbime	12,000.00	10,000.00	16,000.00	17,000.00
Mallra dhe shërbime THV	15,000.00	20,000.00	23,000.00	22,000.00
Shpenzime Kapitale THV				
Zyra e Kuvendit Komunal	259,000.00	269,000.00	273,000.00	277,000.00
Nr. i punëtorëve	0	0	0	0
Paga dhe Shtesa	219,000.00	222,000.00	223,000.00	225,000.00
Mallra dhe shërbime	30,000.00	32,000.00	34,000.00	36,000.00
Mallra dhe shërbime THV	10,000.00	15,000.00	16,000.00	16,000.00

KOMUNA E SUHAREKËS

Buxhet Ekonomi dhe Financa	393,000.00	262,000.00	272,000.00	280,000.00
Nr. i punëtorëve	26	25	25	25
Paga dhe Shtesa	188,000.00	200,000.00	202,000.00	205,000.00
Mallra dhe shërbime	45,000.00	47,000.00	53,000.00	55,000.00
Shpenzime Kapitale	100,000.00			
Mallra dhe shërbime THV	10,000.00	15,000.00	17,000.00	20,000.00
Shpenzime Kapitale THV	50,000.00			
Shërbime Publike, Mbrojtja Civile	4,766,658.00	5,154,483.00	5,609,817.00	6,246,405.00
Nr. i punëtorëve	26	25	25	25
Paga dhe Shtesa	199,000.00	213,000.00	215,000.00	218,000.00
Mallra dhe shërbime	350,000.00	360,000.00	370,000.00	370,000.00
Shpenzime komunale	275,000.00	230,000.00	250,000.00	265,000.00
Shpenzime Kapitale	3,469,189.00	3,546,483.00	3,991,009.00	4,460,282.00
Mallra dhe shërbime THV	70,000.00	75,000.00	80,000.00	82,000.00
Shpenzime komunale THV	50,000.00	60,000.00	63,000.00	64,000.00
Shpenzime Kapitale THV	353,469.00	670,000.00	640,808.00	787,123.00
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	9,200.00	10,000.00	10,500.00	10,500.00
Nr. i punëtorëve	1	1	1	1
Paga dhe Shtesa	7,200.00	8,000.00	8,000.00	8,000.00
Mallra dhe shërbime	2,000.00	2,000.00	2,500.00	2,500.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	1,010,000.00	977,000.00	972,800.00	1,082,000.00
Nr. i punëtorëve	13	4	4	4
Paga dhe Shtesa	84,000.00	42,000.00	43,000.00	44,000.00
Mallra dhe shërbime	40,000.00	45,000.00	53,000.00	55,000.00
Subvencione dhe transfere	200,000.00	210,000.00	220,000.00	240,000.00
Shpenzime Kapitale	390,000.00	420,000.00	400,000.00	500,000.00
Mallra dhe shërbime THV	26,000.00	30,000.00	35,000.00	40,000.00
Subvencione dhe transfere THV	120,000.00	120,000.00	125,000.00	130,000.00
Shpenzime Kapitale THV	150,000.00	110,000.00	96,800.00	73,000.00
Kadastra, Gjeodezia dhe Pronë	138,000.00	148,000.00	154,000.00	157,000.00
Nr. i punëtorëve	14	14	14	14

KOMUNA E SUHAREKËS

Paga dhe Shtesa	113,000.00	118,000.00	120,000.00	122,000.00
Mallra dhe shërbime	18,000.00	20,000.00	22,000.00	22,000.00
Mallra dhe shërbime THV	7,000.00	10,000.00	12,000.00	13,000.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	594,000.00	636,000.00	667,000.00	724,000.00
Nr. i punëtorëve	7	9	9	9
Paga dhe Shtesa	74,000.00	86,000.00	87,000.00	89,000.00
Mallra dhe shërbime	340,000.00	340,000.00	355,000.00	355,000.00
Shpenzime Kapitale	90,000.00	140,000.00	100,000.00	100,000.00
Mallra dhe shërbime THV	60,000.00	70,000.00	75,000.00	80,000.00
Shpenzime Kapitale THV	30,000.00		50,000.00	100,000.00
Administrata e Shëndetësisë	173,000.00	296,000.00	259,000.00	274,000.00
Nr. i punëtorëve	6	6	6	6
Paga dhe Shtesa	48,000.00	51,000.00	52,000.00	54,000.00
Mallra dhe shërbime	15,000.00	20,000.00	22,000.00	23,000.00
Subvencione dhe transfere		105,000.00	55,000.00	60,000.00
Mallra dhe shërbime THV	25,000.00	30,000.00	35,000.00	37,000.00
Subvencione dhe transfere THV	85,000.00	90,000.00	95,000.00	100,000.00
Shërbimet e Kujdesit Primar-QKMF	2,805,486.00	2,700,606.00	2,839,683.00	2,996,461.00
Nr. i punëtorëve	185	198	198	198
Paga dhe Shtesa	1,865,000.00	1,710,822.00	1,831,680.00	1,950,000.00
Mallra dhe shërbime	577,776.00	688,607.00	692,003.00	692,381.00
Shpenzime Komunale	67,630.00	81,600.00	75,000.00	80,000.00
Shpenzime Kapitale		91,576.00	116,000.00	144,080.00
Paga dhe mëditje THV				
Mallra dhe shërbime THV	85,000.00	20,000.00	25,000.00	30,000.00
Shpenzime Kapitale THV	210,000.00	108,424.00	100,000.00	100,000.00
Shërbimet Sociale	121,000.00	128,000.00	138,000.00	141,500.00
Nr. i punëtorëve	13	13	13	13
Paga dhe Shtesa	97,000.00	101,000.00	102,000.00	103,000.00
Mallra dhe shërbime	13,000.00	15,000.00	20,000.00	20,000.00
Shpenzime komunale	6,000.00	5,000.00	6,000.00	6,500.00

KOMUNA E SUHAREKËS

Mallra dhe shërbime THV	7,000.00		10,000.00	12,000.00
Administrata e Arsimit	1,225,000.00	1,654,000.00	1,000,000.00	788,000.00
Nr. i punëtorëve	10	10	10	10
Paga dhe Shtesa	85,000.00	89,000.00	90,000.00	91,000.00
Mallra dhe shërbime	200,000.00	205,000.00	225,000.00	230,000.00
Subvencione dhe transfere	100,000.00	95,000.00	100,000.00	120,000.00
Shpenzime Kapitale	430,000.00	750,000.00	137,000.00	
Mallra dhe shërbime THV	165,000.00	180,000.00	185,000.00	190,000.00
Shpenzime Komunale THV	50,000.00	45,000.00	50,000.00	52,000.00
Subvencione dhe transfere THV	75,000.00	90,000.00	100,000.00	105,000.00
Shpenzime Kapitale THV	120,000.00	100,000.00	113,000.00	
Arsimi Parafillor	287,966.00	287,966.00	301,645.00	314,809.00
Nr. i punëtorëve	36	36	36	36
Paga dhe Shtesa	234,966.00	236,674.00	256,000.00	275,000.00
Mallra dhe shërbime	40,000.00	30,000.00	34,000.00	37,000.00
Shpenzime Komunale	6,000.00	5,000.00	8,000.00	10,000.00
Mallra dhe shërbime THV	7,000.00	10,000.00	10,000.00	13,000.00
Arsimi fillor	6,594,555.00		6,775,417.23	7,178,092.00
Nr. i punëtorëve	753	746	746	746
Paga dhe Shtesa	5,885,903.00	6,154,009.00	6,256,522.00	6,313,181.00
Mallra dhe shërbime	260,000.00	397,262.00	420,000.00	415,000.00
Mallra dhe shërbime-Politika të reja	145,652.00	20,000.00	82,000.00	100,000.00
Shpenzime Komunale	70,000.00	70,000.0	85,000.00	95,000.00
Shpenzime Kapitale	150,000.00	112,048.00	730,000.00	820,000.00
Mallra dhe shërbime THV	15,000.00	15,000.00	20,000.00	22,000.00
Shpenzime Kapitale THV	50,000.00		70,000.00	80,000.00
Shpenzime Komunale THV	18,000.00	20,000.00	23,000.00	25,000.00
Arimi i mesem	1,859,004.00	1,957,840.00	1,968,217.00	2,053,200.00
Nr. i punëtorëve	208	208	208	208
Paga dhe Shtesa	1,656,004.00	1,746,840.00	1,737,217.00	1,798,200.00
Mallra dhe shërbime + Politika të reja	159,000.00	160,000.00	168,000.00	175,000.00

KOMUNA E SUHAREKËS

Shpenzime Komunale	24,000.00	20,000.00	25,000.00	35,000.00
Mallra dhe shërbime THV		10,000.00	15,000.00	20,000.00
Shpenzime komunale THV	20,000.00	21,000.00	23,000.00	25,000.00
Kulturë,Rini ,Sport dhe Mërgatë	889,000.00	1,080,000.00	1,179,000.00	1,277,000.00
Nr. i punëtorëve	14	14	14	14
Paga dhe Shtesa	103,000.00	110,000.00	112,000.00	115,000.00
Mallra dhe shërbime	50,000.00	50,000.00	57,000.00	57,000.00
Subvencione dhe transfere	200,000.00	210,000.00	230,000.00	240,000.00
Shpenzime Kapitale	290,000.00	450,000.00	500,000.00	500,000.00
Mallra dhe shërbime THV	36,000.00	40,000.00	45,000.00	50,000.00
Subvencione dhe transfere THV	100,000.00	120,000.00	130,000.00	140,000.00
Shpenzime Kapitale THV	110,000.00	100,000.00	105,000.00	175,000.00
Qarkorja Buxhetore 2024/01				
Totali :	22,084,869.00	23,284,922.00	23,223,122.23	24,730,524.00
Nr. i punëtorëve	1,376	1,373	1,373	1,3736
Paga dhe Shtesa	11,392,153.00	11,650,345.00	11,909,419.00	12,195,381.00
Mallra dhe shërbime	3,148,428.00	3,338,446.00	3,598,503.00	3,652,881.00
Shpenzime Komunale	586,630.00	557,600.00	608,000.00	657,500.00
Subvencione dhe transfere	955,000.00	1,120,000.00	1,135,000.00	1,218,000.00
Shpenzime Kapitale	6,002,658.00	6,618,531.00	7,174,617.00	7,869,485.00
Totali Komunal :	22,084,869.00	23,284,922.00	24,425,539.00	25,593,247.00
Vitet fiskale	2024	2025	2026	2027

- Nga tabelat e sipërme shifet kuart se të gjitha shpenzimet Komunale janë evidentur sipas kategorive të shpenzimeve dhe sipas programeve buxhetore që operojnë dhe funksionojnë në kuadër të Komunës së Suharekës për peiudhen afatmesme buxhetore 2025 dhe vlerësime të hershme - projeksionet për vitet 2026 - 2027.

PROGRAMET BUXHETORE TË KOMUNËS

Paraqitja e detajuar dhe analitike e ProgrameveBuxhetore të Komunës së Suharekës të regjistruara në sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK).

1.Zyra e Kryetari	624-160-16012-0111
2. Zyra e Kuvendit Komunal.....	624-169-16912-0111
3. Administrata	624-163-16312-0130
4. Inspeksioni	624-166-16612-0130
5. Ekonimi,Buxhet dhe Finaca.....	624-175-17512-0112
6.Sherbimet publike,mjedis dhe emergjencë	624-180-18012-0451
7. Zyra komunale për komunitete dhe kthim.....	624-195-19570-0130
8. Bujqesi Zhvillim Rural dhe Pylltari	624-470-47012-0421
9. Urbanizem dhe Planifikim.....	624-660-66365-0610
10.Shërbime Pronso-Juridike dhe Kadaster	624-660-66060-0660
11.Kultur Rini dge Sportet e Mërgatë	624-850-85012-0820
12.Administrata e Shendetsisë.....	624-730-73021-0740
13.Shërbimet e shëndetësisë primare (QKMF)	624-730-73750-0740
14. Sherbimet sociale.....	624-730-75555-1040
15. Administrata e arsimit.....	624-920-92060-0980
16. Arsimi parashkollor dhe qerdhet.....	624-920-92430-0911
17. Arsimi fillor	624-920-93330-0911
18. Arsimi i mesëm	624-920-94530-0920

 Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa

- ❖ Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa është krijuar me qëllim që bashkëpunimi, bashkëveprimi dhe harmonizimi me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit, Bujqësisë Zhvillim Rural e Pylltarisë si dhe drejtorit tjera që është bazë solide për të garantuar zhvillimin ekonomik lokal dhe realizim të objektivave që dalin nga Korniza Afatmesme Buxhetore, e që ka shërbyer si plan i zhvillimit lokal .
- ❖ Sektori i Ekonomisë është plotësisht në bashkëveprim me objektivat e të gjitha drejtorive që operojnë në kuadër të qeverisë komunale dhe përveq fokusimit në këto objektivë është i fokusuar në prioritetet e dalë nga objektivat strategjike të qeverisë komunale. Veprimtaria e fushës së Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa është profesionale dhe objektivat e saj kryesisht arrihen me punë të përditshme, andaj synim kryesor i saj është që të gjitha këto objektivë të arrihen pa krijuar shpenzime shtesë nga buxheti qendror si dhe buxheti komunal të shpenzohet me efikasitet dhe nikoqirlek.

Deklarata e misionit:

- ❖ Shërbime të kënaqshme, tërheqje të investimeve ,përmirsim i klimës biznesore.
- Politika të reja në vazhdimësi për të hyra dhe buxhetim të shoqëruara me rritje të vazhdueshme të vullnetit dhe përgjegjësisë qytetare.

Deklarata e Qëllimit:

❖ Prioritet e dala nga planet dhe strategjitë e Komunës të cilat janë theksuar edhe të objektivat strategjike të KAB-it 2025 dhe projeksionet 2026-2027 janë bazë edhe për Drejtorin Ekonomi, Buxhet dhe Financa të përqëndruar në klimë adekuate për investime dhe biznese aktuale, rritje të vazhdueshme të qëndrueshme të buxhetit ,rritja e realizimit të të hyrave vetanake si dhe racionalizim të shpenzimeve operative.

❖ **Prioritet e programit e drejtoris për Ekonomi,Buxhetit dhe Financa janë:**

Prioriteti 1:

- Përmirsim i dukshëm i **ambientit të biznesit**, avancim të mëtutjeshëm të **potencialit aktual të ndërmarrësisë** dhe klimë për **tërheqje të investimeve të brendshme dhe atyre të mergimtarëve tanë.**

Prioriteti 2:

- ***Rritja e vazhdueshme e Buxhetit dhe grumbullimi i të hyrave vetanake, e me theks të veçantë i tatimit në pronë dhe tatimit në tokë të shoqëruara me ulje të taksave dhe shërbimeve Administrative, zgjerim të bazës tatimore, krijim i burimeve të reja të të hyrave tatimore brenda hapsirave Komunale .***

Tabela e prioriteteve, objektivave dhe programeve

Prioriteti	Objektivat :	Programi
P1	P1.1.-Shërbime "one stop shop" dhe online	
	P1.2-Planifikim të zonave të reja për investime	
		-Ngritja e kapaciteteve për zona të investimeve (agrobiznes) në Shirokë,Studenqan, Samadraxhë dhe Bllacë .
	P2.1.-Avancim të mëturtyeshëm të rregulloreve për tarifa dhe ngarkesa apo edhe zvoglimi i tarifave.	
	P2.2.-Implementim të politikave të reja për çdo tremujor për arkëtim të të hyrave vetanake	
		-Mënyra dhe forma lehtësuese për tatimpaguesit e rregullt,si dhe parapaguesit vullnetar
	P2.3.-Rritje e vazhdueshme e vullnetit dhe përgjegjësisë qytetare për kryerjen e obligimeve	
	P2	-Vizita të vazhdueshme tatimpaguesve të karakterit edukues dhe këshillues.
	P2.4.-Zgjerim i bazës tatimore dhe krijim të burimeve të reja të të hyrave	
		-Regjistrim të objekteve të reja të tatimit në pronë -Rexhistrim të pasuris-tokës dhe objekteve përcjellëse për tatimim. -Dhënja në shfrytëzim e pronës komunale të pashfrytëzuar -Arkëtim nga lejet dhe legalizimet e ndërtimeve

	P2.5.-Ngritja e kapaciteteve sektoriale për Buxhet dhe Financa
	-Aftësim dhe trajnim i vazhdueshëm i stafit,
	P2.6.-Përmirsim i infrastrukturës fizike dhe teknologjike për Buxhet dhe Financa
	-Renovimi dhe ristrukturimi i hapsirave të punës të përshtatshme për shërbime të qytetarëve -Paisje adekuate teknologjike dhe informatike me sftware adekuat

 Drejtoria për Shërbime Publike,Mjedis dhe Emergjencë

- **Komuna e Suharekës, i përgjigjet kërkesave të shumta të qytetareve** si ndërtimi i infrastrukturës rrugore ,kanalizimeve,mirëmbajtjes së rrjetit të ujit të pijes dhe rrjetit elektrik edhe pse dita e ditës po ndërtohet dhe rindërtohet ajo nga faktoret objektiv dhe subjektiv ajo po dëmtohet në mënyra të ndryshme.Përkushtimi i Qeverisë Komunale do të jetë që ato të mirëmbahen dhe të jenë gjithëher në funksion të qytetarve të saj .

Deklarata e misionit:

- Një komunë e pastër,dhe e sigurt për të gjithë qytetarët e saj.

Deklarata e Vizionit :

- Për të përmbushur obligimet statutores të Drejtorisë dhe adresimin e nevojave të qytetarëve tanë në fushën e rrjetit komunal rrugor, ujit dhe infrastrukturës së mbeturinave, hapësirave të gjelbra, mjedis të pastër shërbimeve emergjente dhe të sigurisë. Ne do të bëjmë këtë dhe arrijmë duke zbatuar mirëmbajtjen e planifikuar dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve, hapësirave publike (duke përfshirë parqet dhe varrezat), furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura dhe rregullimi i kolektorit në rrugën "Skenderbeu", vazhdimi i sheshit të qytetit deri te ura e vogël në rrugën Brigada 123. Ne gjithashtu do të sigurojmë një plan të duhur që është në vend dhe zbatohet për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat e tjera.

 Drejtoria për Inspeksion

Deklarata e misionit:

- Ngritja e nivelit në të gjitha fushat e veprimit të inspeksionit për të mirën e qytetarëve dhe bizneseve të komunës sonë.

Deklarata e Vizionit :

- Inspeksioni Komunal do të trajtoj të gjitha bizneset pa dallime në formatin, veprimtarinë e saj si i vogël i mesëm apo edhe çift biznes i madh.

- **Sherbimet,vizitat dhe informimin do ta kenë të barabart dhe nuk do jenë të diskriminuar për shkak të statusit të tyre biznesor.** Ngritja e cilësisë dhe shpejtimi i shërbimeve në fushat e inspektoratit në të mirë të qytetarëve dhe bizneseve të Komunës sonë.

4.Drejtoria për Bujqësi,Zhvillim Rural dhe Pylltari

- Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari është themeluar me qëllim të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe harmonizimit të planeve dhe programeve me drejtoritë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, dhe drejtoritë komunale tjera për të garantuar zhvillim ekonomik lokal dhe realizim të objektivave strategjike që dalin nga Korniza afatmesme Buxhetore, (qe shërben si strategji e zhvillimit lokal) .

Deklarata e misionit:

- Mbështetja dhe përmirësimin,fuqizimin dhe stimulimi në forcimin e bashkëpunimit në mes të fermerëve, si dhe mundësi të mirë, për rritjen e kapaciteteve prodhuese bujqësore, blegtorale, zhvillimin ekonomik të turizmit rural, dhe bizneseve në përgjithësi.

Deklarata e Vizionit

- Prodhimtari bujqësore dhe blegtorale, industri përpunuese konkurente në tregun e jashtëm dhe të mbrendshëm, këshillime në nxitjen dhe zhvillimi i iniciativave të bujqëve në fushën e prodhimtarisë bujqësore moderne, në rritjen e produktivitetit dhe kualitetit të prodhimtarisë bujqësore, shërbime sa më efikase për qytetarët në lëmin e bujqësisë e zhvillimit rural dhe pylltarisë.

 5. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi e Pronë

Deklarata e misionit:

- Qasja e qytetarve të komunës së Suharekës në të drejtat esenciale të pronave të tyre dhe ofrimi i shërbimeve, ekspertizave në fushat e gjeodezisë, matjeve kadastrale dhe regjistrimi i pronave.

Deklarata e Vizionit:

- Zhvillimi dhe konkretizimi i sistemit të të dhënave mbi pronën e qytetarve, inventarizimi dhe menaxhimi i pronës së palujtshme, rindërtimi i informacioneve kadastrale, përpunimi dhe transparenca. Shërbime efikase dhe precize për qytetar sipas nevojave dhe kërkesës së tyre.

 6. Drejtoria për Urbanizem dhe Plan hapsinor

Deklarata e misionit:

- **Suhareka – Mjedis i garantuar për t'ardhmen e qytetarve**

Deklarata e Qëllimit dhe Prioritetet

- Ngritja dhe përmirësimi i infrastrukturës të integruar dhe shërbime efikase për qytetarët.
- Efiçencë në shfrytëzimin e energjisë, Hartimi i Planit rregullues të hollësishëm Zona Ekonomike –Duhël-Bllacë. Mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit, resurseve natyrore dhe kulturore, Hartimi i Planit të Mobilitetit të transportit. Mjedis i pastër për qytetar si në fshat ashtu edhe në qytet.

 7. Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport e Mërgatë

Deklarata e misionit:

- Ngritja dhe përmirësimi i infrastrukturës kulturore, sportive dhe rinore

Ambient akomodues dhe relaksues për mërgatën, destinacion të favorshëm për investimin e kapaciteteteve të tyre si në kulturë, rini, sport e mërgatë.

Deklarata e Vizionit

- Vizioni i drejtorisë sone është të ju ofrojë përkrahje të rejave dhe të rinjëve që të zhvillojnë aktivitetet e tyre me qëllim të përmbushjes shpirtërore dhe intelektuale të tyre,
- Promovimi dhe përkrahja e artisteve dhe zbulimi i talenteve të rinjë, pasi që Komuna jonë njihet si një vater artistike,
- Masovizimi i përfshirjes së të rejave dhe rinjëve në aktivitete sportive si dhe ofrimi i ambientit sa më bashkëkohorë sportiv,
- Përfshirja e mërgatës në aktivitete kulturore sportive si dhe promovimi i pikave turistike në vende të ndryshme të botës përmes tyre.

Deklarata e Qëllimit dhe Prioritetet

- Ngritja dhe përmirsimi i cilësisë, infrastrukturës dhe shërbimeve në fushën e kulturës, sportit ,rinisë e mërgatës.
 - Tërheqja e investimeve, zbatimi i strategjive, bashkëpunimi me organizata qeveritare dhe joqeveritare me qëllim të një ambienti më të favorshëm për mirëqenje dhe aktivitetit të lirë produktiv dhe shpirtëror të qytetarve të saj.
 - Ngritja e infrastrukturës ;
 - Tërheqja dhe krijimi i fondeve nga mergimtarët tanë;
 - Hartim dhe implementim të strategjive kulturore e sportive.
-
- Qëllimi është që njerzit tanë nga mërgata të priten ngrohtësisht,të ndien veten se janë në shtëpin e tyre dhe tu mundësohet qasje e shpejtë në dokumentacion sipas nevojave të tyre,si dhe kyqje online .

Prioritetet për Mërgatën :

- Shërbime të shpejta dhe adekuate
- Ambient komod për mërgimtarët tanë
- Tërheqja e investimeve nga mërgata
- Binjakizim me komuna jashtë vendit

Objektivat Strategjike:	Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport e Mërgatë
	Objektivi strategjik i drejtorisë se kulturës është promovimi dhe përkrahja e aktiviteteve kulturore, sportive, artistike duke synuar që të përkrahen talentet e rinje të dy gjinive, njëkohësisht edhe sigurimi i infrastrukturës përkatëse kulturore dhe sportive. Objektive tjetër strategjike e drejtorisë se kulturës në komunën tona është edhe ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore lokale. Objektivat e përgjithshme : Objektivat e përgjithshme të drejtorisë sonë janë – përkrahja e talentëve të rinje vajza dhe djem, të të gjitha fushave kulturore, artistike dhe sportive, ruajtja dhe konservim i artefakteve historike të zbuluara në komunën tona, sigurimi i infrastrukturës moderne kulturore dhe sportive, mbajtja e festivaleve të ndryshme, ditëve të poezisë etj.
	Objektivat specifike: 1.-Ngritja e infrastrukturës në Kulturë dhe sport 2.-Implementimi i planit të veprimit për rini • Promovimi i artisteve dhe sportistëve të rinje femra dhe meshkuj • Mbajtja e eventeve të ndryshme sportive dhe kulturore ku talentet e komunës do të shfaqin potencialin e tyre 3.-Ruajtja e trashëgimisë kulturore 4.- Revitalizimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë kulturore

Objektivat:për Mërgaten	Programi
1.Ofrimi i shpejt i shërbimeve posaqërisht në dokumente të gjendjes Civile	• Angazhimi i stafit shtesë dhe zgjatja e orarit të punës për shërbime mërgatës nga Administarta e gjendjes civile - Sherbime të shpejta si “One Stop Shop” dhe online
2.Ambient mikëpritës dhe komod i mërgimtarve tanë	• Programe kulturo argëtues –Diafest dhe Festari • Takimet me mërgimëtarët • Debate rreth probleme që u paraqiten mërgimtarve tanë gjatë qëndrim në vendëlidje
3.Indentifikimi dhe kontaktimi i ivestitorëve nga mërgata	• Profili i komunës • Plani i zhvillimit ekonomik lokal dhe • Fletëpalosja për zonën industriale në Shirokë,Samadraxhë etj.

8.Drejtoria për Administratë dhe Përsone

Deklarata e misionit:

- Avancimi i kapaciteteve njerëzore(stafit te ri të kualifikuar), për ofrimin e shërbimeve për qytetaret në Q.SH.Q si dhe për nevoja të Drejtorive e institucioneve tjera(qeveritare dhe jo qeveritare).
- Gjithashtu përfundimi i punëve logjistike në lehtësimin e përmbledhjes së detyrave të punës së zyrtareve për shërbime ma efikase për nevoja të ekzekutivit të Komunës dhe qytetareve.

Deklarata e vizionit:

- Ne kemi për qëllim të **ofrojmë shërbime cilësore për qytetarët tanë në kohë dhe në mënyrë efikase** nëpërmjet Qendrës së Shërbimit të Qytetarëve. Llojet e shërbimeve që ne ofrojmë janë të gjitha format e shërbimeve dhe të ndihmës juridike për qytetarët, përfshirë regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave të tyre dhe bënë raportimin për kryerjen e lëndëve administrative në përputhje me afatet ligjore.
- Ne gjithashtu sigurojmë mbështetje administrative dhe këshilla për të gjitha drejtoritë tjera komunale dhe Kuvendin për të ju mundësuar atyre që t'i arrijnë objektivat dhe synimet e tyre.
- Lloji i mbështetjes logjistike që ne ofrojmë përfshin ruajtjen, transportin, postën, inventarizimin, sigurinë, përkthimin e dokumenteve zyrtare, mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe mirëmbajtjen dhe sigurimin e ndërtesave. qendror që ofron të gjitha shërbimet, si dhe qasja në shërbimet e Komunës përmes internetit.
 - Poashtu transparenca e Komunës është në nivel të BE-së.

Deklarata e Qëllimit dhe Prioritetet

- Ngritja e cilësisë dhe shpejtimi i shërbimeve në fushat e ndryshme të shërbimeve administrative në të mirë të qytetarëve të saj.
- Zbatimi i sistemeve sa më bashkëkohore, bashkëpunimi me organizata qeveritare dhe joqeveritare me qëllim të lehtësimit dhe shpejtimit të procedurave për marrjen e shërbimeve komunale, gjë që do të ndikon në ngritjen e standardit të jetës, punës dhe biznesit të qytetarëve të Komunës pa dallim. Thënë troq, synimet tona janë që të arrihen standardet e BE-së sa më parë që të jetë e mundur.
- Në kuader të Gjendjes Civile kemi implementuar dy E-kioska në shërbim të qytetarve dhe muajt në vazhdim pritet të implementohet edhe 3-tri E-Kioska të tjera për shërbim të qytetareve 24/7 për dokumentet si: Çertifikatë e lindjes, Ekstrakti i Lindjes, Çertifikatë e Martesës, Çertifikatë e Vendbanimit, Çertifikatë e Shtetësisë, Çertifikatë e Vdekjes.
- Hulumtimi dhe implementimi i sistemeve sa më bashkëkohore, për dokumenta të gjendjes civile si dhe për tu lehtësuar marrjen e tyre është prioritet në vazhdimësi.

• Deklarata e Qëllimit dhe Objektivat

- Pranimi dhe dorëzimi i të gjitha kërkesave dhe parashtresave të qytetareve dhe institucioneve.
- Shqyrtimi me kohë i të gjitha projekteve dhe planifikimi buxhetor për kërkesat dhe obligimet e Drejtorisë.
- Përcjellja e të gjitha kërkesave dhe dhënia e informacioneve qytetareve për të gjitha çështjet administrative në interes të tyre .



9.Shëndetësia dhe Mirëqenja Sociale

Deklarata e misionit:

- Arritja e strategjive , politikave dhe objektivave organizative –shëndetësore të Komunës përmes menagjimit dhe organizimit efikas të DSHMS. Strategji për shërbime sociale në Komunë ,realizimi i politikave sociale dhe qëllimeve për shërbime më të mira do të kujdeset DSHMS –ja përmesë menaxhimit dhe organizimit efikas të QKMF-ës,QMF-ve ,AMF-ve si dhe QPS-ës si njësi buxhetore në vete.

Deklarata e Vizionit:

- Organizon , koordinon dhe mbikqyrë organizimin e kujdesit parësor shëndetësor të qytetarve,shërbimi për nevoja sociale dhe strehim,mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik.Ofrimi i shërbimeve sociale të gjitha kategorive që nga lindja e deri në perkujdesje të pleqërisë .
- **Jo qytetari në nevojë për shërbime por shërbimet në nevojë për qytetarin.** Shërbimet sociale të u ofrohen të gjithë njerëzve në nevojë për shërbime pa dallim si të atyre në vendbanimet urbane dhe atyre në vendbanime rurale,pa dallim gjinie,race,etnie dhe feje.

Deklarata e Qëllimit dhe Prioritet

- Ofrimi i shërbimëve administrative , shëndetësore dhe sociale qytetarëve në nevojë në mënyrë të shpejtë, efikase, sigurimi i shërbimëve shëndetësore të menjëhershme dhe kualitative si dhe verifikimi i diagnozës bazuar në teknologjinë më bashkokëhore për këtë lëmi.
- Sipas kriterëve shëndetësorë parashihet që në çdo 2400 banor të jetë një mjek por kjo nuk është evidente për shkak të numrit të kufizuar të stafit ,dhe numri i limituar me buxhetë, andaj parashohim që përmes projekti të blerjes së shërbimëve(Shtretërit shtepiak)të ju ofrojm qytetarëve shërbime shëndetsore .
- Qëllim tjetër i KAB-it është që të ju dalim në ndihmë personave me nevoja të veçanta përmes projekteve dhe në vazhdimësi të mbështesim qendren „Handikos “e cila përkujdesen për këtë kategori të qytetarve .

Objektivat :

- Vizitat në shtëpi për shtatëzëna dhe fëmijë -përfitues 100% femra
- Vizitat e kujdesit paliativ –përfitues të dy gjinitë
- Bonus banimi –përparësi nënat vetëushqyese 100% F në vitin 2025
- Pako ushimore dhe higjienike për familjet me gjendje të rëndë ekonomike
- Mbështjet finaciare për individ me gjendje të rëndë shëndetsore dhe ekonomike
- Ndertimi i banimit social për 100 familje
- Përmirësimi i ambientit të punës në QPS –Ndertimi i objektit të QPS (sipas PZHK)

 10. Asimi ,Shkenca dhe Teknologjia

Deklarata e misionit:

- Shkollë bashkëkohore me efikasitet të lartë në mësimdhënie dhe mësimnxënje, organizatë që synon të nxënit gjatë gjithë jetës dhe partneritet të përhershëm me komunitetin.

Deklarata e Vizionit:

- Drejtoria Komunale e Arsimit do të sigurojë arsim dhe edukim cilësor tërëjetësor, i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha moshat e nxënësve në mënyrë që individ (nxënësi) të pajiset me shkathtësi të mjaftueshme intelektuale e praktike në përparimin shkencor e teknologjik si dhe social e ekonomik të vendit.

Deklarata e Qëllimit dhe Prioritet

- Sigurimi i hapësirës së nevojshme shkollore ;
- Ngritja e cilësisë në mësimdhënie-mësimnxënje;
 - Arsimitimi i të gjitha grupmoshave ;
 - Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta ;
 - Krijimi i kapaciteteve të reja shkollore ;
- Hapja e profileve të reja në shkollën profesionale sipas ekonomisë së tregut ;
 - Përfshirja e prindërve dhe komunitetit në vendimarrje ;
 - Rregullimi i ambientit të jashtëm të shkollave .



PROGRAMET E VEQANTA

KOMUNALE

11. Zyra e Kryetarit

Vizioni, misioni dhe objektivat e kryetarit të komunës janë të mbështetura plotësisht në programin e tij i cili është i harmonizuar me të gjitha dokumentet strategjike të Komunës së Suharekës.

Deklarata e misionit:

- Performancë të lartë në shërbime të qytetarve, Komunë të zhvilluar dhe dinamike

Misioni i veçantë është që kjo zyrë të jetë funksionalisht e përgjegjshme dhe llogaridhënëse për të arritur rezultatet që avancojnë interesin e qytetarit.

Deklarata e Vizionit:

- Duke ofruar kryesim të fortë dhe këshilla për ekzekutivin dhe zyrtarët e zgjedhur nga Zyra e Kryetarit, kjo zyrë synon të ruajë pastërti në, shëndetin dhe sigurinë e bashkësisë në mënyra që pasqyrojnë dëshirat dhe nevojat e qytetarëve të cilët jetojnë dhe punojnë në Suharekë.
- Ne duhet të krijojmë vende të reja punedhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit për fëmijët tanë dhe të rriturit. Ne gjithashtu duhet të ndjekim mundësitë për të përsheptuar dhe për të zgjeruar biznesin si dhe vitalitetin ekonomik të Suharekës dhe bashkësive bujqësore, veprime në përputhje me mbrojtjen e mjedisit tonë natyror.

• **ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL**

Deklarata e misionit:

- Për t'ishërbyer qytetarët e Komunës, duke siguruar miratimin e duhur të propozimeve nga pjesa e ekzekutivit në përputhje me detyrimet ligjore.

Deklarata e Vizionit:

- Për të siguruar shqyrtimin në kohë dhe Miratimin e politikave dhe rregulloreve komunale dhe planeve statutore, duke përfshirë buxhetin, në një mënyrë cila i lejon ekzekutivit dhe stafit të komunës për të kryer detyrën e tyre në mënyrë efikase dhe efektive.
- Për të siguruar politikë të përshtatshme dhe plane brenda fushëveprimit të kompetencave të Komunës, duke i respektuar të gjitha ligjet, në një mënyrë që përfitimet e qytetarëve të jenë sa më të mëdha.



V. PËRFORMANCA

- Buxhetimi mundëson qasje të orientuar nga rezultatet në qeverisjen lokale. Buxhetimi sipas përformacës motivon të punësuarit dhe menaxherët të realizojnë përparimin e tyre drejtë synimit të ofrimit të shërbimeve më të mira dhe arritjes së objektivave dhe qëllimeve për periudhë trivjeqare fiskale 2025-2027.

❖ Përformanca ka këto qëllime:

- Të siguroj transparencën dhe llogaridhënjen për shfrytëzimin e parasë publike;
- Të ndihmoj rreth përmirësimit të vendimeve buxhetore;
- Të kontribuj në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve;
- Të vlerësoj përparimin drejt arritjes së synimeve të parapara me objektiva dhe prioritet;
- Të identifikoj problemet, rreziqet dhe të metat e në të njëjtën kohë të bëj përmirësimet e duhura për arritjen e qëllimit dhe objektivave komunale .

❖ Përformanca e komunës së Suharekës është e harmonizuar me objektivat strategjik dhe kryesisht është e theksuar në fushat prioritare si më posht:

1. Orientimi i investimeve sipas kërkesave, sugjerimeve dhe rekomandimeve të qytatarve të komunës.

- Investimet kapitale në masë të madhe janë të orientuara në infrastrukturë publike, dhe infrastrukturë rrugore, ujësjellës, ujësjellës, ujësjellës të tokave bujqësore, furnizimi me mekanizëm bujqësor e preparate të tjera për bujqësi si bazë për zhvillim të bujqësisë, blegtorisë dhe fushave tjera të zhvillimit ekonomik.

- **Qytetarët kërkojnë nga Qeveria Komunale infrastrukturë adekuate publike** në mënyrë që të mund të ushtrojnë aktivitetet e tyre jetësore dhe ekonomike pa pengesa .

2. Përkrahja e bujqëve dhe blegtorëve.-

- Një pjesë e konsiderueshme e Buxhetit të Komunës është e destinuar për këtë fushë të rëndësishme të zhvillimit në projekte të ndryshme sipas kërkesave të qytetarve. Gjithashtu edhe fondet e tjera si donacione apo fonde të karakterit zhvillimor janë forcë adekuate për zhvillimin e bujqësisë. E rëndësishme është përkrahja e bujqëve dhe blegtorëve në investime që bëhet nga ADA,DEMOS dhe LDF e që është e vendosur në premisat e Komunës dhe bashkëpunon ngusht me Drejtorinë për Planifikim, Drejtorin për Ekonomi ,Buxhet dhe Financa si dhe Drejtorit tjera.

3. Mbledhja e të hyrave vetanake.-

- Nga paraqitja grafike e ecursisë së të hyrave vetanake shihet një rritje e solide në 2024 krahasuar me vitin paraprak,pasi që qytetarët janë vëditur se këto mjete po u kthehen nëpërmjet instimeve kapitale,subvencione për fermer dhe forma të tjera investive në llogari të tyre.
- Parashikimet për vitet 2025 janë konform Qarkores Buxhetore dhe projeksionet tona për vitet 2026-2027 janë që të hyrat vetanake komunale(THV) nga viti në vit do të kenë një rritje të lehtë e të qëndrueshme që do jetë më stabile dhe e realizueshme si e Hyrë në planin Buxhetor Komunal.
- **Rritja e realizimi me shoqërim të uljes së tatimeve dhe zgjerim të bazës së tatimit në pronë dhe tatimit në tokë, e taksave egzistuese** si dhe mundësin për krijim të burimeve të reja ka bërë që Komuna Jonë të dallohet për të hyrat e realizuara për kokë banori nga të gjitha komunat e tjera në vendë .

- **Aplikimi i politikave të ndryshme çdo tremujor** dhe edukimi i vazhdueshëm i bizneseve dhe rritja e përgjegjësisë të qytetarëve kanë dhënë rezultate të kënaqshme në grumbullimin e këtyre kategorive të të hyrave vetanake.

4. Transparenca dhe llogaridhënja.-

- Është e theksuar transparenca gjatë procesit të planifikimit buxhetor, me mbajtjen e diskutimeve publike për qytetar dhe grupe të interesit, llogaridhënja para qytetarve për formën dhe mënyrën e shpenzimit të parave publike ku qytetari në çdo kohë dhe çdo moment mund të ketë njohuri për parat e dhënë.
- Informacionet mund të merren nga Web faqja e Komunës në çdo kohë dhe sipas nevojës së qytetarve .

5. Menaxhimi financiar.-

- Me theks të veçantë në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) ka bërë që këtë vitë Komuna të ketë një opinion pozitiv të Auditorit të Përgjithshëm sa i përket menaxhimit financiar dhe përpilimit të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) ku kemi marr opinion të pamodifikuar për vitin fiskal 2022 nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
- Jemi në pritje që për vitin fiskal 2023 Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) do të kenë një Opinion të pamodifikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).
- Planifikimi urban dhe rural në listën e projekteve kapitale të vitit të kaluar, edhe këtë vitë dhe viteve të ardhshme i është kushtuar vëmendje e veçantë planifikimit urban dhe planit rregullues jo vetëm të qytetit por edhe zonave të veqanta në disa fshatra të Komunës sonë konform PZHK-së.

6.Menaxhimi i mbeturinave dhe pastrimi i ambientit në komunë.-

- Menaxhimi i mbeturinave në komunë si në zonën urbane ashtu edhe në ato rurale të tërëtorit të komunës. Kjo është arritë me kontraktimin edhe të një kompanie private me partenritet publiko privat(PPP) pasi që kompania publike nuk kishte kapacitete të mjaftueshme për grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e ambientit. Kompania private ka operuar me suksesë dhe performancë të lartë pasi që qytetarët janë të kënaqur me shërbimet e tyre.
- Llogaritët që për vitin 2025 menaxhimi i mbeturinave të kalon nën menaxhimin e Komunës e që shpresojm se ku menaxhim do bëhet edhe më efikas sa i përket grumbullimit të tyre si dhe ikasimit të mjeteve nga qytetaret.

7.Shërbime të shpejta administrative.-

- Shumë shërbime Komunale si leja e punës, leja ndërtimore, dokumentet e gjendjes civile, shërbimet për mërgatën, etj janë përsosur konform kërkesave dhe preferencave të qytetarve nërmjet IT prograve dhe ndërtimit të 2 E-kiosqeve në qytetë.

8.Përmirsimi i ambientit të biznesit.-

- Investimet nga Buxheti i Komunës dhe burime të tjera ambenti i biznesit është përmirësuar dhe po krijohen hapsira të mjaftueshme për biznes nga dita në ditë në qendren biznesore në Shirokë dhe të Agrobiznesit në Samadraxhë .

- Ndërtimi i linjave komunikuese me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile përveq takimeve me tema të veqanta me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile, ata janë pjesë e komisioneve dhe vendimeve me rëndësi për jetën e qytetarit tonë.

9.Rritja e suksesit të nxënësve të të gjitha shkollave të Komunës sonë.-

- Me aplikimin e rregullt të vlerësimit të performancës për mësimdhënës dhe staf administrativ dhe mekanizma të tjerë rezultatet e testit të maturës janë ngritë dukshëm dhe regjistrimi i nxënësve në institucionet e arsimit të lartë dhe superior ka rezultuar me suksesë.Nxënësit e Komunës sonë kan rezultate të kënaqshme në të gjitha lëmit,si në mësim ,sport dhe kulturë dhe aktivitete tjera në nivel vendi.

10.Inkorporimi i shoqërisë civile.-

- Jo vetëm në vendimmarrje por edhe në bellafaqim të identifikimit të nevojave të qytetarve së bashku me të gjitha drejtorit e Komunsës shoqëria civile është e inkorporuar si organizëm në Kuvendin Komunal.
- Debatet me qytaterë për KAB-in dhe sygjerimet e tyre gjithmon kan qenë dhe janë vlerësim dhe korixhim i punës së Qeverisë lokale,të cilat me plotë të drejt edhe inkorpurohen në Kornizen Afatëmesme Buxhetore 2025-2027 .

 Kategorit e shpenzimeve Komunale

• **Pagat dhe Shtesat**

- Kategoria e pagave dhe shtesav është rritur për të gjithë shërbyesit civilë për 0.5% për çdo vit të përvojes së punës,dhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 8/L-196 për Pagat në sektorin publik është rritur bruto masa e pagave krahasuar me vitin aktual.
- Kojo rritje mund të jetë edhe më e lartë pasi që ka shumë gabime për vlerësimin e zyrtarve “për punë të njëjtë pagë të njëjt”.
- **Përlllogaritja e vlerës së koficientit për vitin 2025 nuk është ndyshuar por është llogaritur me 110,00 Euro** sipas ligjit të buxhetit për vitin fiskal 2024,nëse nuk konfirmohet ndryshe nga MFPT apo me ndoni QB tjetër.
- Rritja e buxhetit krahasuar me vitin aktual 5.43%,ku pjesa më e madhe shkon për kategorin e “Paga dhe shtesa”kurse kategorit tjera kan një rritje të lehtë përjashtimbëjn shenzimet komunale si rryma pasi që jemi kyqur në ndrrqimet efiçiente anda edhe kemi zvogluar këtë kategori ekonomike krahasuar me vitin aktual.

• **Mallrat dhe shërbimet**

- Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve janë planifikuar më pakë pasi që buxheti i rritur ka atakuar vetëm pagat dhe shtesat andaj gjat vitit 2025 ka patur rritje simbolike prej 5.03% të kategoris ekonomike “mallra dhe shërbime” krahasuar me vitin aktual e që është konform rritjes buxhetore .

• **Shpenzimet komunale**

- Veçanërisht ulja e shpenzimeve komunale me një përcindje ma të madhe të uljes së shpenzimeve elekektrike, pasi që Komuna në shumë objekte arsimire dhe ndriqim të qytetit ka futur enregjin efçiente për ulje të shpenzimeve, çmimet e derivateve po stabilizohen si dhe shërbimeve tjera komunale e të cilat shpenzime janë planifikuar të mbulohen nga të hyrat vetanake Komunale.
- Këto shpenzime janë planifikuar të ken një ulje të lehtë krahasuar me vitin aktual 4.95% por që ka mundësi që të ketë rritje të derivateve dhe komunalive tjera gjatë vitit fiskal 2025.

▪ **Subvencionet dhe Transferet**

- Kjo kategori e shpenzimeve **është planifikuar me një rritje të justifikuar** dhe me një arsye të domosdoshme mbështetur në nevoja dhe kërkesa relevante me tendencë të rritjes se shpenzimeve per këtë kategori ekonomike.

- Rritje të subvencioneve do të ketë për arsim ,shendetësi,bujqësi,Shëndetësi por nuk do të mungoi as kultura dhe sporti,si dhe nuk do mungoj përkrahja për zyren e kryetarit për personat me nevoja të veqanta dhe kërkesa të ndryshme për qytetaret në nevojë . Rritja e tyre prej 17.28% krahasuar me vitin aktual ,tregon për përkushtimin e Komunës për qytetaret e saj,ku mjetet e inkasuara nga qytetaret ua përkthen qytetarve të saj me subvencione dhe ndihma të ndryshme për gjat vitit fiskal 2025.

▪ Shpenzimet Kapitale

- Shpenzimet kapitale që finacohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe ai vetanak kanë një rritje të lehtë krahasuar me vitin aktual prej 9.90%.
- Kjo kategori ekonomike ka rritje të lehtë krahasuar me vitin aktual 2024 por që kërkesat e qytetrave janë vazhdimisht në rritje për infrastruktur,si kanalizime ujësjellës ,salla sportive e të ngjajshme .
- Burimet e finasimit të planifikuara nga të hyrat vetanake janë fokusuar kryesisht në përmbushjen e objektivave strategjike për projekte të rëndësishme kapitale.
- Keqëklasifikimet të cilat vijnë nga auditimet e rregullta nga ZKA-ja kemi qenë të detyruar që edhe me Qarkoren Buxhetore 2025/01 ti zvoglojm investimet kapitale për pjesen e që ato projekte kapitale të kalojn në kategorin ekonomike si"mallra & sherbime" dhe kategorin ekonomike"subvencione & transfere" andaj ketogoria e Investimeve kapitale për vitin 2025 ka një rritje të lehtë krahasuar me vitin aktual 2024 .

 6. Programi Komunal i Investimeve Publike (PIP)

- **Programi Komunal për Investime Publike përfshinë të gjitha projektet te cilat do të aprovohen, sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin Komunal për vitet 2025–2027** nga ana e Kuvendit të Komunës të Suharekës sipas dëgjimeve buxhetore të zhvilluara gjatë vitit fiskal 2024 në tërësinë të territorit të Komunës.
- **Në tabelën e mëposhtme po e paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me Buxhetin Komunal të vitit 2025,** me financim nga të hyrat vetanake dhe nga Buxheti i Republikës së Kosovës, si dhe listën e projekteve kapitale me projeksione për vitet 2026 dhe 2027.
- **Kjo listë mund të modifikohet sipas një qarkore tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës** ose me propozime dhe kërkesa nga komuniteti dhe fokus grupe të qytetarëve të ndryshëm për bashkfinancim, donacione si dhe grante.
- **Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale** - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të Komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaqme në aspektin e planifikimit, për Komunën tonë.
- Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur zhvillimin e Komunës për një rritje ekonomike stabile.
- Kategori e shpenzimeve kapitale, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm biznesor për ngritje të pjesëmarrjes të sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës.
- Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme.
- Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës sonë në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

KOMUNA E SUHAREKËS

LISTAE PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP) planifikuara për vitin fiskal 2025 dhe projeksionet 2026-2027

	FONDI BURIMOR (10)	FONDI BURIMOR (21)	TOTAL: 2025	TOTAL: 2026	TOTAL: 2027	TOTAL: 2025-2027
TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE 2025-2027	5,510,107.00	1,108,424.00	6,618,531.00	7,174,617.00	7,869,485.00	21,662,633.00
Shërbiet Publike, Mjedis, dhe Emergjencë	3,546,483.00	670,000.00	4,216,483.00	4,631,817.00	5,247,405.00	14,095,705.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Bllacë	60,000.00	20,000.00	80,000.00	86,000.00	90,000.00	256,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Breshanc	10,000.00	-	10,000.00	10,800.00	15,000.00	35,800.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Budakovë	40,000.00	10,000.00	50,000.00	54,000.00	60,000.00	164,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale Bukosh	30,000.00	10,000.00	40,000.00	44,000.00	50,000.00	134,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale Delloc	10,000.00	-	10,000.00	10,000.00	12,000.00	32,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale Doberdelan	25,000.00	5,000.00	30,000.00	33,000.00	40,000.00	103,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Dubravë	25,000.00	5,000.00	30,000.00	35,000.00	40,000.00	105,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Duhel	25,000.00	5,000.00	30,000.00	35,000.00	40,000.00	105,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Dvoran	10,000.00	-	10,000.00	12,000.00	15,000.00	37,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Gelanc	15,000.00	5,000.00	20,000.00	22,000.00	25,000.00	67,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Gjinoc	40,000.00	20,000.00	60,000.00	65,000.00	75,000.00	200,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Grejkoc	60,000.00	10,000.00	70,000.00	80,000.00	90,000.00	240,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Grejqevc	35,000.00	15,000.00	50,000.00	54,000.00	60,000.00	164,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Javor	15,000.00	5,000.00	20,000.00	22,000.00	25,000.00	67,000.00

KOMUNA E SUHAREKËS

Ndërtimi i rrugëve lokale në Kasterc	10,000.00	-	10,000.00	12,000.00	15,000.00	37,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Krushicë e Eperme	8,000.00	2,000.00	10,000.00	11,000.00	15,000.00	36,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Krushicë e Poshtme	8,000.00	2,000.00	10,000.00	10,000.00	13,000.00	33,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Leshan	25,000.00	5,000.00	30,000.00	32,400.00	40,000.00	102,400.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Luzhnicë	8,000.00	2,000.00	10,000.00	10,800.00	15,000.00	35,800.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Maqitevë	65,000.00	35,000.00	100,000.00	108,000.00	12,500.00	220,500.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Mohlan	10,000.00	5,000.00	15,000.00	16,000.00	20,000.00	51,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Mushtisht	40,000.00	40,000.00	80,000.00	85,000.00	126,060.00	291,060.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Neperebisht	15,000.00	5,000.00	20,000.00	22,000.00	25,000.00	67,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Nishor	15,000.00	5,000.00	20,000.00	22,000.00	25,000.00	67,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Papaz	8,000.00	2,000.00	10,000.00	10,000.00	12,000.00	32,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Peqan	35,000.00	5,000.00	40,000.00	44,000.00	50,000.00	134,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Popovlan	10,000.00	-	10,000.00	11,000.00	15,000.00	36,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Qadrak	15,000.00	5,000.00	20,000.00	22,000.00	25,000.00	67,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Reqan	20,000.00	5,000.00	25,000.00	27,000.00	35,000.00	87,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Reshtan	15,000.00	5,000.00	20,000.00	21,600.00	40,000.00	81,600.00
Instalimi dhe sanimi i ndriqimeve publike, në fshatra dhe qytet.	265,000.00	35,000.00	300,000.00	357,217.00	285,000.00	942,217.00
Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Komunë"	355,000.00	45,000.00	400,000.00	442,000.00	450,000.00	1,292,000.00
Ndërtimi i shtreterve të lumenjeve dhe rikonstruimi tyre.	50,000.00	10,000.00	60,000.00	65,000.00	75,000.00	200,000.00

KOMUNA E SUHAREKËS

Ndërtimi i trotuarëve dhe parkingjeve në Suharekë.	90,000.00	10,000.00	100,000.00	110,000.00	120,000.00	330,000.00
Ndërtimi i zonave të gjelbruara dhe rekreative në fshatra dhe Suharekë	85,000.00	15,000.00	100,000.00	108,000.00	120,000.00	328,000.00
Ndërtimi i urave në fshatra dhe Komunë.	90,000.00	10,000.00	100,000.00	108,000.00	130,000.00	338,000.00
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit në fshatra dhe në Komunë	90,000.00	10,000.00	100,000.00	108,000.00	130,000.00	338,000.00
Blerja e paisjeve për funksionalizimin e kompanisë Eko-Theranda .	180,000.00	20,000.00	200,000.00	216,000.00	220,000.00	636,000.00
Regullimi dhe rikonstruimi i lumit "Toplluha" në Suharekë	161,483.00	-	161,483.00	170,000.00	202,905.00	534,388.00
Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve lokale në Komunë	390,000.00	80,000.00	470,000.00	533,600.00	573,940.00	1,577,540.00
Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në Biraq .	200,000.00	30,000.00	230,000.00	248,400.00	430,000.00	908,400.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Sallagrazhdë	35,000.00	5,000.00	40,000.00	45,000.00	55,000.00	140,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Samadraxhë	60,000.00	20,000.00	80,000.00	87,000.00	90,000.00	257,000.00
Ndërtimi i objektit për qëndrim ditë për pensionistë në Samadraxhë	45,000.00	5,000.00	50,000.00	54,000.00	60,000.00	164,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Savrovë	20,000.00	-	20,000.00	22,000.00	25,000.00	67,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Semetisht	45,000.00	5,000.00	50,000.00	54,000.00	60,000.00	164,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Sopijë	40,000.00	20,000.00	60,000.00	65,000.00	75,000.00	200,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Stravuçinë	10,000.00	-	10,000.00	11,000.00	15,000.00	36,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Studençan	60,000.00	20,000.00	80,000.00	86,000.00	90,000.00	256,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Sllapuzhan	25,000.00	-	25,000.00	27,000.00	35,000.00	87,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Shirokë	18,000.00	2,000.00	20,000.00	22,000.00	25,000.00	67,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale Topliqan	20,000.00	-	20,000.00	22,000.00	25,000.00	67,000.00

KOMUNA E SUHAREKËS

Ndërtimi i rrugëve lokale Tërrnje	25,000.00	5,000.00	30,000.00	33,000.00	40,000.00	103,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Vërshec	10,000.00	-	10,000.00	10,000.00	15,000.00	35,000.00
Ndërtimi i rrugëve lokale në Vraniq	50,000.00	10,000.00	60,000.00	65,000.00	75,000.00	200,000.00
Nërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë	80,000.00	20,000.00	100,000.00	108,000.00	130,000.00	338,000.00
Nërtimi i impiantit për ujra të zeza në Sllapuzhanë	80,000.00	20,000.00	100,000.00	108,000.00	125,000.00	333,000.00
Ndërtimi i rrugëve në Suharekë ,Mushtisht,Bllacë,Studenqan dhe Samdraxhë me USAD-in	260,000.00	40,000.00	300,000.00	319,000.00	450,000.00	1,069,000.00
Administrata & Personeli	-	20,000.00	20,000.00	25,000.00	30,000.00	75,000.00
Ndërtimi i objektit të Kuvendit Komunal në Suharekë	-	20,000.00	20,000.00	25,000.00	30,000.00	75,000.00
Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim	140,000.00	-	140,000.00	150,000.00	200,000.00	490,000.00
Ndërtimi i zonave infrastrukturore SMART në hapsirat ku kalojnë këmbësorët-zebat në pjesët e qytetit në Komunën e Suharekës .	50,000.00	-	50,000.00	50,000.00	70,000.00	170,000.00
Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve në zonën urbane në Suharekë	90,000.00	-	90,000.00	100,000.00	130,000.00	320,000.00
Bujqësia Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	420,000.00	110,000.00	530,000.00	496,800.00	573,000.00	1,599,800.00
Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore në Studenqan	20,000.00	40,000.00	60,000.00	64,800.00	50,000.00	174,800.00
Projekte me bashkëfinancim	330,000.00	40,000.00	370,000.00	324,000.00	359,940.00	1,053,940.00
Ndërtimi i infrastrukturës rrugore për bujqësi dhe pylltari në Komunë	70,000.00	30,000.00	100,000.00	108,000.00	163,060.00	371,060.00
Kultura,Rina,Sporti dhe Mërgata	450,000.00	100,000.00	550,000.00	605,000.00	675,000.00	465,000.00
Ndërtimi i Kullës së dëshmorve në Budakovë	120,000.00	20,000.00	140,000.00	155,000.00	170,000.00	465,000.00
Ndërtimi i Kullës së dëshmorve në Doberdelan	130,000.00	20,000.00	150,000.00	230,000.00	250,000.00	630,000.00

KOMUNA E SUHAREKËS

Ndërtimi i memorialit te "Gurra e Kadisë" në Budakovë	40,000.00	20,000.00	60,000.00	70,000.00	80,000.00	210,000.00
Ndërtimi dhe rikonstruimi I memorialveve në fshatra dhe Suharekë	80,000.00	20,000.00	100,000.00	150,000.00	175,000.00	425,000.00
Ndërtimi i fushave sportive dhe parqeve rekreative në Komunë	80,000.00	20,000.00	100,000.00	-		100,000.00
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	91,576.00	108,424.00	200,000.00	216,000.00	244,080.00	660,080.00
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (QKMF)	91,576.00	108,424.00	200,000.00	216,000.00	244,080.00	660,080.00
Blerja dhe paisja me aparatura te nevojshme per QKMF"Rexhep Kuçi" Suharekë	25,000.00	25,000.00	50,000.00	60,000.00	64,080.00	174,080.00
Ndërtimi dhe rikonstruimi I QKMF-së,në Suharekë ,QMF dhe AMF në Reqan dhe Gjinoc	51,576.00	58,424.00	110,000.00	100,000.00	120,000.00	330,000.00
Blerja e veturës për dializë	15,000.00	25,000.00	40,000.00	56,000.00	60,000.00	156,000.00
Arsimi dhe Shkenca	862,048.00	100,000.00	962,048.00	1,050,000.00	900,000.00	2,912,048.00
ADMINISTRATA- Arsimi	750,000.00	100,000.00	850,000.00	250,000.00	-	1,100,000.00
Ndërtimi i pullazit në Gjymnazin "Jeta e Re "në Suharekë	150,000.00	50,000.00	200,000.00	-	-	200,000.00
Ndërtimi i aneksit të SHHMU"Rilindja " në Njëprebisht	230,000.00	30,000.00	260,000.00	-	-	260,000.00
Ndërtimi i salles se sportit në Bukosh	240,000.00		240,000.00	-	-	240,000.00
Ndërtimi i salles se sportit në Peqan	130,000.00	20,000.00	150,000.00	250,000.00	-	400,000.00
Arsimi Fillor	112,048.00	-	112,048.00	800,000.00	900,000.00	1,812,048.00
Ndërtimi i SHFMU"7 Marsi" në Suharekë	112,048.00	-	112,048.00	800,000.00	900,000.00	1,812,048.00

Qershor 2024

**Kryetari i Komunës
/Bali Muharremaj /**